



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Datë 04.07.2023]

Formulari nr. 3

FTESE PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Bashkia Tiranë
Adresa Sheshi “Skenderbej”, Tiranë
Tel/Fax 0035542256799
E-mail administrative.prokurime@tirana.al
Adresa e Internetit www.tirana.al

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: **“Blerje 4 (katër) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Budapest -Tiranë”**.

Data e zhvillimit do të jetë **04.07.2023 ora 17.00** në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit):

1. “Blerje 1 (një) biletë udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Budapest -Tiranë”, si më poshtë:

- Nisja nga Tirana drejt Budapest do të bëhet në datën 06.07.2023 në orën 18.20, mbërritja në Budapest në orën 23.40.
- Nisja nga Budapest drejt Tiranës do të bëhet në datën 07.07.2023, në orën 16.50, mbërritja në Tiranë, në orën 00.45.

Me një ndalesë, bagazhe të përfshira.

2. “Blerje 1 (një) biletë udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Budapest -Tiranë”, si më poshtë:

- Nisja nga Tirana drejt Budapest do të bëhet në datën 06.07.2023 në orën 10.00, mbërritja në Budapest në orën 17.30, (Me një ndalesë).

- Nisja nga Budapest drejt Tiranës do të bëhet në datën 08.07.2023, në orën 13.30, mbërritja në Tiranë, në orën 15.00,(Direkt, bagazhe të përfshira).

3. “Blerje 2 (dy) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Vienë- Budapest -Tiranë”, si më poshtë:

- Nisja nga Tirana drejt Vienës do të bëhet në datën 06.07.2023 në orën 12.05, mbërritja në orën 13.35.

- Nisja nga Budapest drejt Tiranës do të bëhet në datën 08.07.2023, në orën 13.30, mbërritja në Tiranë, në orën 15.00.

Direkt, bagazhe të përfshira.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

a) Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.

**Operatori ekonomik së bashku me itinerarin e ofruar, duhet të paraqesë edhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni, e-mail) në sistem. Nëse itinerari i ofruar nga OE është në përputhje me kërkesat e AK dhe sipas destinacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktor pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit ekonomik.*

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Me marrjen e njoftimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë për realizimin apo pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit, brenda 2 (dy) orëve nga momenti i njoftimit të operatorit nga Komisioni i sistemit dinamik të biletave. Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit duhet të jepen arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të dorëzojë biletën elektronike elektronikisht (email: administrative.prokurime@tirana.al) brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në rast se ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë në “Ftesën për ofertë” do të përzgjidhet ofertuesi i renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur e fundit të mbetur në klasifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentave: Brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.